



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të Neni 48 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14 dhe 153/15), Neni 42 paragrafi 2 i Ligjit për Punë Devizore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13, 97/15 dhe 153/15) dhe pikës 12 të Vendimit për mënyrën dhe kushtet për regjistrimin dhe depozitimin e raporteve për operacionet e kryera kreditore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 173/15), guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi si në vijim:

UDHËZIM për mënyrën dhe kushtet e raportimit individual për kreditë e mara nga jorezidentët

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton mënyrën dhe kushtet e regjistrimit dhe raportimit individual të kredive të marra nga jorezidentët, formularët e raportimit dhe mënyrën e plotësimit të tyre.

Evidenca e operacioneve kreditore me jorezidentë dhe raportimi i tyre kryhen për qëllime statistikore.

II. MËNYRA E RAPORTIMIT

2. Rezidenti (në tekstin e mëtejshëm: raportuesi) i cili ka lidhur kontratë kredie me jorezident duhet ta njoftojë Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) për kontratën e lidhur për kredinë në afat prej 10 ditësh pune nga dita e lidhjes së kontratës.

Raportuesi do të njoftojë gjithashtu Bankën Popullore për të gjithë qarkullimin (transaksionet e përdorimit dhe pagesat e kryegjësë dhe interesit) në afat prej 5 ditësh pune nga data e transaksionit.

Raportuesi do të njoftojë Bankën Popullore për çdo ndryshim në kontratën e kredisë në afat prej 5 ditësh pune nga data e ndryshimit.

Rezidenti mund t'i japë autorizim me shkrim një banke të autorizuar ose një personi tjetër juridik për të raportuar në emër të tij për kreditë e marra nga jorezidentët.

3. Për nevojat e raportimit përdoren formularët e mëposhtëm:

3.1. ND 1 - Aplikimi për kredi të marrë nga jorezident.

Formulari ND 1 - Aplikimi për kredi të marrë nga jorezident, depozitohet gjatë raportimit për operacion të ri kreditimi. Raporti plotësohet në bazë të kushteve dhe elementeve të kontratës për kredi. Banka Popullore evidenton operacionin e kreditimit dhe ndan numër unik kredisë. Në raportimin e mëtejshëm mbi operacionin e kreditimit, raportuesi duhet t'i referohet numrit unik të kredisë.

3.2. ND 2 –Realizimi i përdorimit.

Formulari ND 2 - Realizimi i përdorimit depozitohet gjatë raportimit për shfrytëzimin e mjeteve nga kredia e marrë, bazuar në operacionin kreditor të regjistruara më parë.

3.3. ND 3 –Realizimi i pagesës.

Formulari ND 3 - Realizimi i pagesës, depozitohet gjatë raportimit për pagesën e kryegjësë/interesit në bazë të operacionit kreditor të evidentuar më parë.

3.4. ND 4 - Plani i pagesës së kryegjësë.

Formulari ND 4 - Plani i pagesës së kryegjësë raportohet nëse në përputhje me kontratën e kredisë, plani i paraparë i pagesës nuk ka periodicitet të rregullt, d.m.th. janë raportuar pagesa të parregullta të kryegjësë të cilat nuk mund të llogariten në përputhje me kushtet bazë të kredisë. Në atë rast, gjatë raportimit për përdorimin e mjeteve të kredisë, formulari ND 4 - Plani i pagesës së kryegjësë depozitohet së bashku me formularin ND 2 - Realizimi i përdorimit.

3.5. ND 5 - Specifikimi i kreditorëve/përfituesve.

Formulari ND 5 - Specifikimi i kreditorëve/ përfituesve, përdoret nëse, në përputhje me kontratën e kredisë, paraqiten më shumë kreditorë ose përfitues të kredisë. Në atë rast, së bashku me formularin ND 1 - Aplikimi për kredi të marrë nga jorezident, depozitohet formulari ND 5 - Specifikimi i kreditorëve/përfituesve, ku renditen kreditorët/përfituesit individualë dhe shumat që u përkasin atyre.

Formularët depozitohen në Bankën Popullore në formë të shtypur, në 1 ekzemplar. Banka Popullore mund të vendosë edhe depozitim elektronik të të dhënave si metodë alternative raportimi.

4. Gjatë ndryshimit të elementeve të caktuara të kontratës së kredisë ose gjatë përfundimit të kontratës, raportohet në formularin ND 1 - Aplikim për kredi të marrë nga jorezident, duke zgjedhur opsionet "ndryshim" ose "anulim".

Gjatë ndryshimit të përfituesve/kreditorëve, raportohet në formularin ND 5 - Specifikimi i kreditorëve/përfituesve, duke zgjedhur opsionet "ndryshim" ose "anulim".

Në rastet e raportimit të gabuar ose ndryshimit të informacionit të disponueshëm në momentin e raportimit, depozitohet anulim i formularit adekuat të planit dhe/ose realizimit me qëllim zhvlerësimin e formularit ekzistues. Së bashku me planin e anuluar depozitohet edhe formular i ri, i saktë i planit dhe/ose realizimit.

5. Në kuadër të raportimit për operacion kreditor, çdo formular apo dokument i depozituar ka numër rendor unik. Numri i dokumentit nuk mund të përsëritet në kornizat e një aplikacioni për kredi.

6. Çdo formular vërtetohet me nënshkrimin e debitorit-rezident dhe/ose raportuesit, duke garantuar në këtë mënyrë saktësinë e të dhënave të depozituara në Bankën Popullore.

III. MËNYRA E PLOTËSIMIT TË FORMULARËVE

7. Me formularin ND 1 – Aplikimi për kredi të marrë nga jorezident raportohet për:

- aplikim i ri për kredi,
- ndryshimi i aplikimit të kredisë,
- anulimi i aplikimit për kredi,
- anulimi i pjesës së papërdorur nga kredia.

Raportim për aplikim të ri për kredi

8. Gjatë raportimit për punë të re kreditore, formulari ND 1 plotësohet në këtë mënyrë:

8.1. Në shenjë **1. Lloji i raportimit** shënohet vetëm fusha 5 "Aplikacion i ri". Fushat 1, 2, 3 dhe 4 plotësohen nga Banka Popullore.

8.2. Në shenjë **2. Kontrata për kredi** fushat plotësohen si më poshtë:

- Në fushën 1 „Data e kontratës” shkruhet data në të cilën është lidhur kontrata ndërmjet debitorit dhe kreditorit.
- Në fushën 2 „Lloji i kontratës” shkruhet kodi dhe emri i llojit të kontratës.

Lloje dhe kode të kontratës:

40 – *E rregullt* - kontratë kredie normale, e cila përmban elementet bazë të operacionit të kreditimit: shumën, kushtet për dhënien, përdorimin dhe kthimin e kredisë.

41 –*Kornizë*- lloj kontrate për kredi që parashikon përdorimin e shumës totale të kornizës së kredisë në këste të shumta, përkatësisht, kredi individuale. Shuma totale e të gjitha kredive individuale nuk mund të jetë më e madhe se shuma e kornizës, ndërsa kushtet e kredive individuale nuk duhet të jenë të njëjta.

42 - *E rregullt si pjesë e një kontratës kornizë - kredi individuale (këst) si pjesë e kredisë kornizë.*

43 - *Linjë*- kontratë me të cilën kreditori i lejon debitorit të përdorë një shumë të caktuar maksimale për një periudhë të caktuar kohore. Me një linjë kredie, kreditori i vë mjetet në dispozicion të debitorit, por deri në momentin e tërheqjes reale të mjeteve, nuk ka detyrim për t'i kthyer ato.

45 - *Rivolving*-kontratë për kredi që përcakton kufi të sipërm huamarrjeje, ku brenda një periudhe të caktuar kohore është i mundur kthimi i një pjese të mjeteve të kredisë dhe ripërdorimi i mjeteve, por gjatë kësaj nuk duhet të tejkalohet kufiri i sipërm i huamarrjes.

46 - *Riorganizim* - kontratë me të cilën kreditori dhe debitori ndryshojnë kushtet fillestare për kthimin e kredisë. Riorganizimi mund të ndodhë në formën e:

Riprogramimi, kontratë me të cilën kreditori i jep debitorit kushte të modifikuara për shlyerjen e kontratës për kredi të lidhur më parë (zgjatja e periudhës së pagesës ose ndryshimi i normës së interesit);

Rifinancim, kontratë me të cilën kreditori dhe debitori bien dakord për kredi të re për të kthyer një kredi të lidhur më parë.

49 –*Letrat me vlerë të borxhit* - të gjitha letrat me vlerë të borxhit të tregtuara në tregje të organizuara ose në tregje të tjera financiare. Në këtë rast, dëshmi e ekzistimit të borxhit është letra me vlerë.

50 –*Marrja e borxhit* - rrjedh nga kontrata për marrjen e plotë ose të pjesshme të borxhit ekzistues të rezidentit-debitor nga rezident tjetër. Borxhi i marrë më së shpeshti rregullohet me kushte të reja kreditimi.

-Fusha 3 "Aplikimi kornizë" plotësohet nëse raportohet këst i kontratës kornizë, d.m.th. nëse fusha 2 përmban kodin për llojin e kontratës 42 - e rregullt si pjesë kontratës kornizë.

-Fusha 4 "Kodi i riorganizimit" plotësohet nga Banka Popullore..

-Në fushën 5 "Shuma e kredisë" shkruani shumën e kredisë të përcaktuar në kontratë, me 2 decimale.

-Në fushën 6 "Valuta" shkruhet kodi dhe emri i valutës nga lista e kodeve të valutave që është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e kryerjes së transaksioneve të pagesave ndërkombëtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/11, 156/11, 58/12, 173/12, 51/13, 144/13, 151/13, 186/13, 96/14, 125/14, 19/15 dhe 106/15).

-Në fushën 7 "Afati i kredisë" shënohet afati i kredisë nga kontrata e kredisë, si më poshtë: në rubrikën e parë "Vite" shënohen vitet - numri i viteve të plota; në fushën e dytë "Muaj" shkruhen muajt (nga 0 deri në 11). Afati i kredisë llogaritet nga data e nënshkrimit të kontratës ose nga data e përdorimit të parë, deri në datën e fundit të pagesës së kryegjësë. Të dhënat e kohëzgjatjes së kredisë përfshijnë gjithashtu periudhën e pritjes.

-Në fushën 8 "Periudha e pritjes" shkruhet periudha e pritjes e kontratës së kredisë, si vijon: në rubrikën e parë "Vite" shënohen vitet, numri i viteve të

plota; në fushën e dytë "Muajt" shkruhen muajt (nga 0 deri në 11). Periudha e pritjes llogaritet nga data e nënshkrimit të kontratës ose nga data e përdorimit të parë deri në datën e pagesës së parë të kryegjësë.

8.3. Në shenjën **3. Debitori** fushat plotësohen si më poshtë:

-Në fushën 1 "Numri identifikues" shënohet numri identifikues i debitorit (rezidenti që ka kryer operacionin e kredisë me një jorezident), si dhe emri, adresa dhe selia e debitorit. Nëse debitori është person fizik, në rubrikën 1 "Numri identifikues" shënohet kodi i personit fizik "1000000", si dhe emri dhe adresa e debitorit.

-Në fushën 2 "Sektori" shkruhen kodi dhe emri i sektorit të cilit i përket debitori. Shtojca-kodi i sektorëve të debitorëve (në përputhje me Vendimin për Klasifikimin Kombëtar të Sektorëve Institucionalë) është pjesë përbërëse e Udhëzimit.- [1.Sektori i debitorit](#)

8.4. Në shenjën **4. Kreditori** fushat plotësohen si më poshtë:

-Fusha 1 „Kodi” plotësohet nga Banka popullore. Me përjashtim, kur në kredi paraqiten më shumë kreditorë, në fushën 1 „Kodi” shkruhet fjala „më shumë”. Me aplikimin detyrimisht depozitohet specifikim i kreditorëve në formularin ND 5 duke deklaruar të gjitha të dhënat e përcaktuara. Raportuesi duhet të japë informacion për emrin dhe adresën e kreditorit.

-Në fushën 2 „Shteti” shkruhen kodi dhe emri i shtetit në të cilin ka seli kreditori nga lista e kodeve të vendeve dhe organizatave ndërkombëtare, e cila është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e kryerjes së transaksioneve të pagesave ndërkombëtare.

-Në fushën 3 „Sektori” shkruhen kodi dhe emri i sektorit të cilit i përket kreditori. Shtojca - Libri i kodeve të sektorëve të kreditorëve është pjesë përbërëse e Udhëzimeve. - [2.Sektori i kreditorit.](#)

-Fusha 4 „Persona të lidhur” plotësohet sipas marrëdhënies kapitale të debitorit dhe kreditorit.

Nën „Lloji” shkruhet kodi i llojit të lidhjes, si më poshtë:

- 0 - Kur nuk ka lidhje ndërmjet kreditorit dhe debitorit;
- 1 - kur kreditori merr pjesë me më shumë se 50% në kapitalin e debitorit;
- 2 - kur kreditori merr pjesë me më shumë se 10% në kapitalin e debitorit;
- 3 - kur debitori merr pjesë me më shumë se 50% në kapitalin e kreditorit;
- 4 - kur debitori merr pjesë me më shumë se 10% në kapitalin e kreditorit;
- 7 - kur debitori dhe kreditori janë të lidhur horizontalisht brenda të njëjtit grup investitorësh të drejtpërdrejtë jorezidentë;

8 - kur debitori dhe kreditori janë të lidhur horizontalisht brenda të njëjtit grup investitorësh të drejtpërdrejtë rezidentë;

9 - kur debitori dhe kreditori janë të lidhur vertikalisht brenda të njëjtit grup investitorësh të drejtpërdrejtë jorezidentë;

10 - kur debitori dhe kreditori janë të lidhur vertikalisht brenda të njëjtit grup investitorësh të drejtpërdrejtë rezidentë.

Nën "Pjesëmarrja", nëse zgjidhen kodet 1, 2, 3 ose 4, shkruhet përqindja e pjesëmarrjes në kapital. Nëse zgjidhen kodet 7, 8, 9 dhe 10, nuk shkruhet përqindja e pjesëmarrjes në kapital.

8.5. Në shenjën **5. Lloji dhe qëllimi i kredisë** fushat plotësohen në këtë mënyrë:

-Në fushën 1 „Lloji i kredisë” shkruhet kodi dhe emri i llojit të kredisë nga libri i kodeve që është pjesë e Udhëzimeve-[3. Lloji i kredisë.](#)

Lloji i kredisë përcaktohet në bazë të kontratës së kredisë dhe mund të jetë:

Kredi komerciale (kredi tregtare - pagesa e shtyrë) - nëse kontrata e kredisë parashikon shitjen e mallrave ose shërbimeve ndërmjet shitësit dhe blerësit me periudhë shlyerjeje mbi një vit.;

Kredia komerciale (kredi tregtare - paradhënie) - nëse kontrata e kredisë parashikon marrjen e paradhënies për eksportin e ardhshëm të mallrave ose shërbimeve që do të kryhet brenda një periudhe më të gjatë se një vit;

Kredia mallrash - nëse kreditori (institucioni financiar ose institucioni për kreditimin e eksportit) e ka përcaktuar qëllimin e tij paraprakisht në kontratën e kredisë, d.m.th. e miratuar për pagesën e mallrave ose shërbimeve në tregtinë ndërkombëtare;

Kredi e mallrave (hua) - nëse me kontratën kreditori i jep hua mjete financiare drejtpërdrejt debitorit (përfshirë linjat e kredisë afatshkurtra të bankës);

Letrat me vlerë të borxhit - Emetimi i letrave me vlerë të borxhit nga rezidenti;

Kontrata e riblerjes së letrave me vlerë (kontrata repo);

Kredi subordinare - kredi financiare që, në rast falimentimi ose likuidimi, do të paguhet para aksionarëve dhe pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve të tjerë.

Kredi e sindikuar - kredi financiare e miratuar nga një grup kreditorësh, e administruar nga një ose më shumë banka (agjentë);

Shpërndarja e të drejtave speciale të tërheqjes (DST) - Fondi Monetar Ndërkombëtar;

Lizingu financiar - nëse me kontratën për lizing dhënësi i lizingut i jep në përdorim sendin e lizingut përfituesit të lizingut, pa kalim të pronësisë, për një periudhë të caktuar kohore dhe nën kushte të caktuara.

- Në fushën 2 „Qëllimi i kredisë” shkruhen kodi dhe emri i qëllimit të kredisë nga libri i kodeve i cili është pjesë përbërëse e udhëzimeve - [4. Qëllime për lloje të caktuara kredisë.](#)

8.6. Në shenjën **6. Sigurimi** fushat plotësohen si më poshtë:

- Në fushën 1 „E siguruar” shënojmë „po”, nëse kontrata e kredisë parashikon instrument të caktuar sigurie, ose shënojmë „jo” nëse kredia nuk është e siguruar.

Nëse kredia është e siguruar, fushat e mbetura të kësaj shenje plotësohen si më poshtë:

-Në fushën 2„Lloji i sigurimit” shkruhen kodi i llojit të sigurimit nga libri i kodeve i cili është pjesë përbërëse e Udhëzimeve - [5. Forma e sigurimit.](#)

- Në fushën 3 „Numri identifikues/kodi” shkruhet: për rezidentin dhënë të garancisë së kredisë - numri identifikues i firmës ose për person fizik kodi "1000000"; për jorezident dhënë të sigurimit të kredisë, kodi vendoset nga Banka Popullore.

Raportuesi detyrimisht duhet të deklarojë emrin dhe selinë e regjistruar të dhënësit të sigurisë së kredisë.

Kur kontrata parashikon 2 forma sigurie, forma e dytë e sigurimit shkruhet në pjesën e dytë të kësaj fushe.

Kur operacioni është siguruar me më shumë se 2 forma, në shenjën 13 „Vërejtje” shënohen të dhënat për ta.

-Në fushën 4 „E garantuar publikisht”është e detyrueshme të plotësohet. Shënojmë „po” nëse kontrata e kredisë parashikon garanci ose instrument tjetër sigurie të lëshuar nga Qeveria ose agjenci qeveritare. Kur kredia nuk është e garantuar publikisht, shënojmë „jo”.

8.7. Në shenjën **7. Kryegjëja** fushat plotësohen si më poshtë:

- Në fushën 1 „Mënyra e pagesës” shënojmë mënyrën e pagesës së kredisë në përputhje me kontratën për kredi, me mundësi për zgjedhjen e opsioneve të mëposhtme:

Kryegjëja në shuma të barabarta - Nënkupton pagesën e shumave të barabarta, në intervale të njëjta kohore brenda një viti kalendarik, p.sh. mujore, tremujore, gjashtëmujore, çdo vit gjatë gjithë periudhës së pagesës së kredisë.

Pagesa të parregullta të kryegjësë - Nëse zgjidhet ky opsion, raportuesi duhet të depozitojë formularin ND 4 - Plani i pagesës së kryegjësë të shumës së kredisë së përdorur.

Anuiteti - Një metodë pagese e anuitetit është pagesa në shuma të barabarta në të cilën anuiteti përfshin shumat e kryegjësë dhe interesit. Nëse zgjidhet ky opsion, duhet të plotësohet edhe fusha "Shuma e anuitetit".

Pagesa në një shumë - Me këtë metodë pagese, datat e para dhe të fundit të pagesës së kryegjësë janë të njëjta.

Përdorimi individual - Ky opsion zgjidhet nëse kontrata e kredisë kërkon ripagimin individual të çdo përdorimi të veçantë, brenda një periudhe të caktuar fikse. Në fushën "Numri i muajve" për këtë opsion shkruhet afati i pagesës i përdorimeve individuale.

-Në fushën 2 „Buxheti“ shënojmë „po“, kur burimi i mjeteve për pagesën e kredisë së marrë është Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Në të gjitha rastet e tjera, shënohet "jo".

- Në fushën 3 „Numri i pagesave në vit“ shkruhet numri i pagesave të kryegjësë në një vit kalendarik, nëse është pagesë e rregullt periodike (kombinimet e mëposhtme janë të mundshme: 1 për pagesat vjetore; 2 për pagesat gjashtëmujore; 4 për pagesat tremujore; 12 për pagesat mujore).

- Në fushën 4 „Numri i përgjithshëm i pagesave“ shkruhet numri total i pagesave të kryegjësë gjatë afatit të kredisë.

- Në fushën 5 „Data e parë e pagesës“ shkruhet data e parë e pagesës së kryegjësë.

- Në fushën 6 „Data e fundit e pagesës “ shkruhet data e fundit e pagesës së kryegjësë.

8.8. Në shenjë **8. Interesi** fushat plotësohen në këtë mënyrë:

-Në fushën1 „Lloji i normës së interesit“ shkruhen kodi dhe emri i llojit të normës së interesit nga libri i kodeve të normave të interesit, i cili është pjesë përbërëse e udhëzimeve. - [6. Lloje të normave të interesit.](#)

-Fusha 2 „Lartësia e normës së interesit“ shkruhet lartësia e normës së interesit në përqindje me 4 decimale. Kur norma e interesit është e ndryshueshme, shkruhet lartësia e normës së interesit në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës.

- Në fushën 3 „Marzhi“ shkruhet lartësia e marzhit (pjesa fikse e normës së ndryshueshme të interesit), në përqindje me 4 decimale.

- Në fushën 4 „Data e parë e pagesës“ shkruhet data e parë e pagesës së interesit.

- Në fushën 5 „Data e fundit e pagesës“ shkruhet data e fundit e pagesës së interesit.

Nëse në kontratën e kredisë janë parashikuar më shumë norma interesi gjatë afatit të kredisë, për çdo periudhë ndryshimi depozitohet formulari ND 1 për ndryshime, gjë me të cilën ndryshohet kjo shenjë.

-Në fushën 6 „Interes i vonuar“ shkruhet kodi dhe emri i llojit të normës së interesit i cili aplikohet për pagesat me vonesë, nga libri i kodeve të normës së interesit, i cili është pjesë përbërëse e udhëzimeve.- [6. Lloje të normave të interesit.](#)

- Në fushën 7 „Lartësia e normës së interesit“ shkruhet shuma e normës së kamatës së vonuar, në përqindje me 4 decimale. Kur norma e interesit është e ndryshueshme, shkruhet norma e interesit në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës.

- Në fushën 8 „Marzhi“ shkruhet shuma e marzhit (pjesa fikse e normës së interesit të ndryshueshme të vonuar) në përqindje me 4 decimale.

-Në fushën 9 „Numri i pagesave në vit“ shkruhet numri i pagesave të interesit në një vit kalendarik, nëse është pagesë e rregullt periodike (kombinimet e mëposhtme janë të mundshme: 1 për pagesat vjetore; 2 për pagesat gjashtëmujore; 4 për pagesat tremujore; 12 për pagesat mujore).

-Fusha 10 „Mënyra e përlogaritjes së interesit“ plotësohet si më poshtë: në fushën "Për muaj" shënohet 1, nëse për llogaritjen e interesit përdoret numri kalendarik i ditëve për muajin ose 2 nëse çdo muaj llogaritet sikur të kishte 30 ditë; Në fushën "Për vit", shënohet 1 nëse për llogaritjen e interesit përdoret numri kalendarik i ditëve në vit, ose 2 nëse viti konsiderohet të ketë 360 ditë.

8.9. Në shenjë **9. Shpenzime** shkruhen shpenzimet totale të kredisë të parashikuara në kontratën e kredisë, si përqindje e shumës së kredisë, me 4 shifra decimale.

Fushat plotësohen si më poshtë:

- Fusha 1 „Vjetore” plotësohet kur shpenzimet paguhen disa herë gjatë gjithë periudhës së kredisë.

- Fusha 2 „E njëhershme” plotësohet kur shpenzimet paguhen në 1 shumë.

Evidentohen llojet e mëposhtme të shpenzimeve:

- komision për pjesën e papërdorur të kredisë;
- komision për menaxhimin e kredisë;
- komision për kontratën e kredisë;
- shpenzime të tjera-shpenzime të tjera janë shpenzime që nuk mbulohen nga llojet e mëparshme.

8.10. Shenja **10. Përfituesi i kredisë** plotësohet vetëm nëse, në përputhje me rregullativën ligjore, si pjesëmarrës - përfitues i mjeteve në operacionin e kredisë, në kontratën e kredisë është parashikuar rezident tjetër.

-Në fushën 1 „Numri identifikues” shkruhet numri identifikues, emri dhe adresa/selia e përfituesit të kredisë. Nëse përfituesi i kredisë është person fizik, shënohet kodi i personit fizik “1000000”. Nëse ka shumë përfitues të përfshirë në transaksion, në fushën 1 “Numri identifikues” shkruhet fjala “më shumë” dhe me aplikimin depozitohet detyrimisht specifikimi i përfituesve të kredisë në formularin ND 5.

8.11. Shenja **11. Institucion i huaj sigurimi** plotësohet nëse kontrata e kredisë parashikon që kredia do të sigurohet te një institucion i huaj sigurimi.

-Fusha 1 “Kodi” plotësohet nga Banka Popullore dhe raportuesi shënon të dhënat për emrin, selinë dhe shtetin e institucionit të sigurimit.

-Në fushën 2 “Përqindja e sigurimit” shkruhet përqindja e sigurimit të shumës së kredisë, me 4 shifra decimale.

8.12. Shenja **12. Raportues për aplikimin** plotësohet me të dhënat për debitorin, nëse ai vetë raporton për operacionin kreditor ose për person të autorizuar- raportues, kur debitori autorizon person tjetër juridik që të raportojë për operacionin kreditor në Bankën Popullore.

-Në fushën 1 “Numri identifikues” shkruani numrin identifikues të firmës, emrin, adresën dhe selinë.

- Në fushën 2 "Personi kontaktues" shkruani emrin dhe mbiemrin e personit kontaktues, numrat e telefonit dhe faksit dhe adresën e-mail. Shenja konfirmohet me nënshkrimin e personit përgjegjës të raportuesit.

8.13. Në shenjën **13. Vërejtje** shkruhen informacione shtesë në lidhje me operacionin kreditor që raportuesi mendon se duhet t'i vihen në dispozicion Bankës Popullore.

8.14. Në shenjën **14. Vërtetimi i kërkesës – debitori** shkruhen emri dhe mbiemri i personit përgjegjës të debitorit. Të dhënat e përcaktuara në kërkesë vërtetohen me nënshkrimin e personit përgjegjës të debitorit.

Raportim për ndryshimin e aplikimit për kredi

9. Disa të dhëna mund të ndryshojnë si rezultat i ndryshimit të kushteve kontraktuale të kredisë, duke depozituar aneks të kontratës ose dokument tjetër nga i cili mund të shihen ndryshimet e kushteve.

Ndryshimi i debitorit dhe valutës së një aplikacioni tashmë të evidentuar nuk mund të bëhet duke ndryshuar kërkesën për kredi. Për ndryshime të tilla në marrëdhëniet kontraktuale, duhet të depozitohet kërkesë e re për kredi dhe ajo ekzistuese të mbyllet.

Nëse, për shkak të ndryshimeve specifike në elementet bazë të kredisë, ndryshimet e duhura nuk mund të bëhen në aplikacionin ekzistues për kredi, Banka Popullore rezervon të drejtën dakordohet me raportuesin për mënyrë tjetër regjistrimi të ndryshimeve.

Për ndryshimin e aplikimit për kredi raportohet në formularin ND 1 si më poshtë:

- Në shenjën "Lloji i raportimit", në fushën 2 "Numri i kredisë", shkruhet numrin e evidentimit të kredisë në të cilin është evidentuar në Bankën Popullore.
- Fusha 3 "Numri i dokumentit" shënohet numri rendor i dokumentit.
- Shënohet fusha 6 "Ndryshim i aplikacionit" dhe shënohet data e ndryshimit.
- Në pikat 2-13 të formularit ND 1 plotësohen vetëm fushat që ndryshojnë në përputhje me ndryshimet kontraktuale.

Raportuesi duhet të plotësojë formularin në shenjën 12 dhe debitori duhet ta vërtetojë atë në shenjën 14.

Raportim për anulimin e aplikimit për kredi

10. Anulimi i kërkesës për kredi të marrë nga jorezident bëhet si rezultat i përfundimit të kontratës së kredisë, në një situatë kur ajo nuk është ekzekutuar fare, d.m.th. kur nuk ka ndodhur asnjë transaksion në bazë të operacionit kreditor.

Anulimi i aplikimit për kredi raportohet në formularin ND 1, si më poshtë:

- Në shenjë "Lloji i raportimit", në fushën 2 "Numri i kredisë", shkruhet numri i regjistrimit të kredisë në të cilin është evidentuar në Bankën Popullore.
- Në fushën 3 "Numri i dokumentit" shënohet numri rendor i dokumentit.
- Shënohet fusha 7 "Anulimi i aplikimit" dhe shënohet data e përfundimit të kontratës së kredisë.

Fushat e mbetura të formularit ND 1 nuk plotësohen.

Raportuesi detyrimisht duhet të plotësojë formularin në shenjë 12 dhe debitori duhet ta vërtetojë atë në shenjë 14.

Raportim për anulimin e pjesës së papërdorur të kredisë

11. Në rast se palët kontraktuese arrijnë marrëveshje të ndërsjellë për të mos përdorur një pjesë të kredisë, debitori, në bazë të një dokumenti me shkrim që shpreh pëlqimin e tillë të palëve kontraktuese, raporton për anulimin e pjesës së papërdorur të kredisë.

Anulimi i pjesës së papërdorur të kredisë raportohet në Formularin ND 1, si më poshtë:

- Në fushën "Lloji i raportimit", në fushën 2 "Numri i kredisë", shkruhet numri i evidentimit të kredisë me të cilin është evidentuar në Bankën Popullore.
- Në rubrikën 3 "Numri i dokumentit" shënohet numri rendor i dokumentit.
- Shënohet fusha 8 "Anulimi i pjesës së papërdorur të kredisë" dhe shënohet data e kontratës së arritur dhe shuma e pjesës së papërdorur të kredisë që anulohet.

Fushat e mbetura të formularit ND 1 nuk plotësohen.

Raportuesi duhet të plotësojë formularin në shenjë 12 dhe debitori duhet ta vërtetojë atë në shenjë 14.

12. Me formularin ND 2 - Realizimi i përdorimit raportohet në:

- përdorim i ri,
- anulimi i dokumenti të paraqitur paraprakisht për përdorim.

Raportim për përdorim të ri

13. Për të raportuar për përdorim të ri, formulari ND 2 plotësohet si më poshtë::

- Në fushën 1 "Numri i kredisë" shkruhet numri unik i kredisë në të cilin është evidentuar në Bankën Popullore.
- Në fushën 2 "Numri i dokumentit" shkruhet numri rendor i dokumentit.
- Në fushën 3 "Shuma e përdorimit" është shuma totale e përdorimit (përmbledhja e shumave nga fusha 9) me 2 decimale.
- Në fushën 4 "Përdorim i ri" shënohet fusha për përdorim të ri.
- Në fushën 6 "Numër rendor" shënohet numri rendor i çdo zëri.
- Në fushën 7 "Kodi i përdorimit" shkruhet një nga kodet e mëposhtme:
 - 1 - përdorimi në para (pasuri financiare);
 - 2 -përdorimi në bazë të kredive për riorganizimin e borxhit. Përdorimi i kredive për riorganizimin e borxhit ndodh gjithmonë në lidhje me mbylljen e borxhit nga kreditë e vjetra që riorganizohen;
 - 3 -përdorim fiktiv - për shkak të transferimit të borxhit për "çështje specifike" nga një aplikacion që mbyllet në një aplikacion tjetër që hapet. Përdorimi fiktiv ndodh gjithmonë në lidhje me pagesën fiktive, e cila në raste specifike shuan borxhin në aplikacionin e vjetër, ndërsa përdorimi fiktiv krijon borxh për aplikim tjetër në shumën e borxhit të mëparshëm;
 - 4 -rritja e borxhit bazuar në kapitalizimin e interesit;
 - 5 -përdorim në mallra;
 - 6 -përdorim në shërbime;
 - 7 -përdorimi si rezultat i konvertimit të kapitalit në borxh;
 - 8 -përdorimi si rezultat i konvertimit të letrave me vlerë të borxhit në hua;
 - 9 -konvertimi i një paradhënie kredie tregtare në hua;
 - 10 -konvertimi i kredisë tregtare të importit në hua;
 - 11-përdorimi si rezultat i shpenzimeve të mbajtura bazuar në kontratën e kredisë;
 - 12 - përdorimi si rezultat i ndryshimit të statusit nga rezident në jorezident ose jorezident në rezident.
- Në fushën 8 "Data e përdorimit" shënohet data e përdorimit të mjeteve.
- Në fushën 9 „Shuma" shkruhet shuma e përdorimit me 2 decimale.
- Në fushën 10 "Gjendja e borxhit" shkruhet gjendja e re e borxhit në nivel aplikimi si shuma e statusit të borxhit të mëparshëm dhe shumës së përdorimit nga fusha 9.
- Fusha 11 "Vërejtje" përdoret për informacion shtesë që raportuesi mendon se duhet t'i vihet në dispozicion Bankës Popullore.

- Në fushën 12 "Raportues" shënohet data e depozitimit, vendoset nënshkrimi i personave të autorizuar të raportuesit.

Raportim për anulimin e dokumentit të depozituar paraprakisht për përdorim

14. Për raportimin në lidhje me dokument të depozituar paraprakisht për përdorim, formulari ND 2 plotësohet si më poshtë:

- Në fushën 1 "Numri i kredisë" shkruhet numri i kredisë me të cilin është evidentuar në Bankën Popullore.
- Në fushën 2 "Numri i dokumentit" shënohet numri rendor i dokumentit.
- Shënohet fusha 5 "Anulimi i përdorimit" dhe shënohet numri i dokumentit që anulohet.
- Fushat e mbetura nga 6 deri në 11 nuk plotësohen.
- Në fushën 12 "Raportues" shënohet data e depozitimit dhe vendoset nënshkrimi i personave të autorizuar të raportuesit.

15. Formulari ND 3 - Realizimi i pagesës përdoret për të raportuar:

- Pagesë të re,
- anulim të dokumentit të depozituar paraprakisht për pagesë.

Raportim për shlyerjen e re

16. Formulari ND 3 plotësohet si më poshtë::

- Në fushën 1 "Numri i kredisë" shkruhet numrin e kredisë me të cilin është evidentuar në Bankën Popullore.
- Në fushën 2 "Numri i dokumentit" shënohet numri rendor i dokumentit.
- Në fushën 3 "Shuma totale e paguar" shënohet me 2 shifra decimale shuma totale e pagesës (shuma e shumave nga fusha 11).
- Fusha 4 "Kryegjëja" shënohet nëse me dokumentin raportohet për pagesat e kryegjësë.
- Fusha 5 "Interesi" shënohet nëse me dokumentin raportohet për pagesat e interesit.
- Në fushën 6 "E re" shënohet fusha për pagesën e re.
- Në fushën 8 "Numri rendor" shënohet numri rendor i çdo zëri.
- Në fushën 9 "Kodi i pagesës" shkruhet një nga kodet e mëposhtme:
 - 1 -pagesa në para (pasuri financiare);
 - 2-mbyllja pas riorganizimit të borxhit. Pagesa e riorganizimit të borxhit ndodh gjithmonë në lidhje me përdorimin e kredisë në aplikim tjetër kredie;
 - 3 -pagesë fiktive - për shkak të transferimit të borxhit për çështje specifike nga një aplikacion që mbyllet në një aplikacion tjetër që hapet. Pagesa fiktive ndodh gjithmonë në lidhje me përdorimin fiktiv, i cili në raste specifike

shuan borxhin në aplikacionin e vjetër, ndërsa përdorimi fiktiv krijon borxh për aplikim tjetër në shumën e borxhit të mëparshëm;

4 -kapitalizimi i interesit - shndërrimi në borxh;

5 -kamata e paguar me vonesë;

6 -konvertimi i borxhit në kapital vetjak;

7 -shndërrimi i borxhit të bazuar në kredi në letra me vlerë borxhi;

8 -falja e borxhit;

9 -pagesë në mallra;

10 -pagesë duke kryer shërbime;

11 -reduktimi i borxhit si rezultat i ndryshimit të statusit nga rezident në jorezident;

12 -interesi i vonuar i riprogramuar;

13 -forma të tjera të konvertimit të borxhit;

14 - ulja e borxhit bazuar në marrjen e borxhit nga jorezident;

15 - ulja e borxhit bazuar në blerjen e të arkëtueshmeve të kredisë të jorezidentit nga ana e rezidentit;

16 - falja e borxhit.

- Në fushën 10 "Data e pagesës" shënohet data e pagesës.
- Në fushën 11 "Shuma" shkruhet shuma e pagesës me 2 shifra decimale.
- Fusha 12 "Gjendja e borxhit (gjendja e interesit të paguar)". Nëse bëhet fjalë për pagesën e kryegjësë, në këtë fushë shkruhet gjendja e borxhit si diferencë midis bilancit të mëparshëm të borxhit dhe shumës së kryegjësë të paguar nga fusha 11. Nëse bëhet fjalë për pagesën e interesit, kjo fushë përmban shumën kumulative të interesit të paguar si shumë e bilancit të mëparshëm të interesit të paguar dhe shumën e interesit të paguar nga fusha 11.
- Fusha 13 "Vërejtje" përdoret për informacion shtesë që raportuesi mendon se duhet t'i vihet në dispozicion Bankës Popullore.
- Në rubrikën 14 "Raportues" shënohet data e depozitimit, vendoset nënshkrimi i personave të autorizuar të raportuesit.

Raportim për anulimin e dokumentit të depozituar paraprakisht për pagesë

17. Për raportimin e anulimit të dokumenti të depozituar paraprakisht për pagesë, formulari ND 3 plotësohet si më poshtë:

- Në fushën 1 "Numri i kredisë" shkruhet numri i kredisë me të cilin është evidentuar në Bankën Popullore.
- Në fushën 2 "Numri i dokumentit" shënohet numri rendor i dokumentit.
- Në rubrikën 4 "Kryegjësja" shënohet nëse anulohet pagesa e kryegjësë.
- Shënohet fusha 5 "Interesi" nëse anulohet pagesa e interesit.
- Shënohet fusha 7 "Anulimi i pagesës" dhe shënohet numri i dokumentit që anulohet.

Fushat e mbetura nga 8 deri në 12 nuk plotësohen.

- Në rubrikën 14 "Raportuesi", shënohet data e depozitimit dhe vendoset nënshkrimi i personave të autorizuar të raportuesit.

ND 4 –Plani për pagesën e kryegjësë

18. Raportuesi duhet të depozitojë planin e pagesës së kryegjësë vetëm nëse mënyra e shlyerjes së kryegjësë në formularin ND 1 përcaktohet duke zgjedhur opsionin e pagesave të parregullta të kryegjësë. Plani pagesës së kryegjësë depozitohet pas raportimit për përdorimin e fondeve të kredisë ose ndryshimin e kushteve të pagesës së kredisë. Plani i pagesës së kryegjësë duhet të përgatitet bazuar në shumën e bilancit aktual të borxhit.

Raportim për planin e ri

19. Formulari ND 4 plotësohet si më poshtë::

- Në fushën 1 "Numri i kredisë" shkruani numrin e kredisë me të cilin është evidentuar në Bankën Popullore.
- Në fushën 2 "Numri i dokumentit" shënohet numri rendor i dokumentit.
- Në fushën 3 "Shuma totale e planit" shkruhet shuma totale e planit (përmbledhja e shumave nga fusha 8) me 2 shifra decimale.
- Në fushën 4 "Plani i ri" shënohet fusha "plani i ri".
- Në fushën 6 "Numër rendor" shënohet numri rendor i çdo zëri.
- Në fushën 7 "Data e pagesës" shkruhet data e zërit të planit.
- Në fushën 8 "Shuma" shkruhet me 2 shifra decimale shuma e zërit të planit.
- Fusha 9 "Vërejtje" përdoret për informacion shtesë që raportuesi mendon se duhet t'i vihet në dispozicion Bankës Popullore.
- Në rubrikën 10 "Raportues" shënohet data e depozitimit, vendoset nënshkrimi i personave të autorizuar të raportuesit.

Raportim për anulimin e dokumentit të planit të depozituar paraprakisht

20. Për raportimin e anulimit të dokumentit të planit të depozituar paraprakisht, formulari ND 4 plotësohet si më poshtë:

- Në fushën 1 "Numri i kredisë" shkruhet numri i kredisë me të cilin është evidentuar në Bankën Popullore.
- Në fushën 2 "Numri i dokumentit" shënohet numri rendor i dokumentit.
- Shënohet fusha 5 "Anulimi i planit" dhe shkruhet numri i dokumentit që anulohet.
- Fushat e mbetura nga 6 deri në 8 nuk plotësohen.
- Në fushën 10 "Raportuesi", shënohet data e depozitimit dhe vendoset nënshkrimi i personave të autorizuar të raportuesit.

ND 5 –Specifikimi i kreditorëve/përfituesve

21. Formulari ND 5 depozitohet me raport për kredi të marrë nga rezidenti nga një jorezident në rastet kur duhet të jepet specifikimi i kreditorëve (shenja 4 e formularit ND 1) ose specifikim i përfituesve (shenja 10 e formularit ND 1).

Raportim për specifikim të ri

22. Formulari ND 5 plotësohet si më poshtë:

- Për specifikimet e përdoruesit, nuk plotësohen fushat 10, 13 dhe 15.
- Për specifikimin e kreditorëve, nuk plotësohen fushat 9 dhe 10.
- Në fushën 1 "Numri i kredisë" shkruhet numri i kredisë me të cilin është evidentuar në Bankën Popullore.
- Në fushën 2 "Numri i dokumentit" shënohet numri rendor i dokumentit.
- Në fushën 3 "Shuma totale" shkruhet shuma totale e specifikimit (përmbledhja e shumave nga fusha 16) me 2 shifra decimale.
- Në fushën 4 "Lloji i specifikimit" shkruhet kodi i llojit të specifikimit, përkatësisht: 1 nëse është specifikim për përdoruesit, 2 nëse është specifikim për kreditorët.
- Në fushën 5 "E re" shënohet fusha për specifikim të ri.
- Në fushën 8 "Numri rendor" shënohet numri rendor i çdo zëri.
- Në fushën 9 "Numri identifikues" shkruani numri identifikues i firmës vendase-përfituese të kredisë. Nëse përfituesi i kredisë është person fizik, përdoret kodi i personit fizik "1000000".
- Fusha 10 "Kodi jorezident" plotësohet nga Banka Popullore.
- Në fushën 11 "Emri/Titulli" shkruhet emri i përfituesit/kreditorit të kredisë.
- Në fushën 12 "Adresa/selia" shkruhet adresa dhe selia qendrore e përfituesit të kredisë/kreditorit.
- Në fushën 13 "Shteti" shkruhet kodi dhe emri i shtetit në të cilin ka selinë kreditori, nga kodet e shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, që është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e kryerjes së transaksioneve të pagesave ndërkombëtare.
- Në rubrikën 14 "Sektori" shënohet sektori i përfituesit/kreditorit të kredisë, në përputhje me kodet përkatëse.
- Fusha 15 "Palët e lidhura" plotësohet në përputhje me marrëdhëniet kapitale të debitorit dhe kreditorit.
- Nën "Lloji" shkruhet kodi për llojin e lidhjes, si më poshtë:
 - 0 - kur nuk ka lidhje ndërmjet kreditorit dhe debitorit;
 - 1 - kur kreditori merr pjesë me më shumë se 10% në kapitalin e debitorit;
 - 2 - kur kreditori merr pjesë me më shumë se 50% në kapitalin e debitorit;
 - 3 - kur debitori merr pjesë me më shumë se 10% në kapitalin e kreditorit;
 - 4 - kur debitori merr pjesë me më shumë se 50% në kapitalin e kreditorit;

- 7 - kur debitori dhe kreditori janë të lidhur horizontalisht brenda të njëjtit grup investitorësh të drejtpërdrejtë jorezidentë;
 - 8 - kur debitori dhe kreditori janë të lidhur horizontalisht brenda të njëjtit grup investitorësh të drejtpërdrejtë rezidentë;
 - 9 - kur debitori dhe kreditori janë të lidhur vertikalisht brenda të njëjtit grup investitorësh të drejtpërdrejtë jorezidentë;
 - 10 - kur debitori dhe kreditori janë të lidhur vertikalisht brenda të njëjtit grup investitorësh të drejtpërdrejtë rezidentë.
- Te "Pjesëmarrja", nëse zgjidhen kodet 1, 2, 3 ose 4, shkruhet përqindja e pjesëmarrjes në kapital. Nëse zgjidhen kodet 7, 8, 9 dhe 10, nuk shkruhet përqindja e pjesëmarrjes në kapital.
 - Në fushën 16 "Shuma" shkruhet shuma e kredisë që i përket përfituesit/kreditorit përkatës.
 - Fusha 17 "Vërejtje" përdoret për informacion shtesë që raportuesi mendon se duhet t'i vihet në dispozicion Bankës Popullore.
 - Në fushën 18 "Raportuesi", shënohet data e depozitimit, dhe vendoset nënshkrimi i personave të autorizuar të raportuesit.

Raportim për ndryshimin e specifikimit të depozituar paraprakisht

23. Ndryshimi i specifikimit bëhet duke shënuar në fushën 6 "Ndryshimi" dhe duke shënuar numrin e dokumentit që ndryshohet. Në dokument plotësohen vetëm fushat që ndryshohen.

Në rubrikën 18 "Raportuesi" shkruhet data e depozitimit, vendoset nënshkrimi i personave të autorizuar të raportuesit.

Raportim për anulimin e specifikimit të depozituar paraprakisht

24. Specifikimi i anulimit bëhet duke shënuar në fushën 7 "anulim" dhe duke specifikuar numrin e dokumentit që anulohet. Fushat e mbetura nga 8 deri në 16 nuk plotësohen.

Në rubrikën 18 "Raportuesi" – Plotësohet data e depozitimit dhe vendoset nënshkrimi i personave të autorizuar të raportuesit.

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

25. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet Udhëzimi për mënyrën dhe kushtet e raportimit individual të kredive të marra nga jorezidentët (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 162/10, 186/13 dhe 97/14).

26. Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e shpalljes në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë".

U nr. 37633
26 nëntor 2015
Shkup

Guvernator
Dimitar Bogov

Shtojcë- kode**1. Sektori i debitorit**

Kodi	Sektori
1	Ekonomia totale
11	Shoqëri jofinanciare
11 001	Shoqëri publike jofinanciare
11 002	Shoqëri private jofinanciare vendase
11 003	Shoqëri jofinanciare të kontrolluara nga jashtë
12	Shoqëri financiare
121	Banka Qendrore
122	Institucione të tjera monetare dhe financiare
122 01	Institucionet monetare dhe financiare publike
122 02	Institucione private monetare dhe financiare
122 03	Institucionet monetare dhe financiare të kontrolluara nga jashtë
123	Ndërmjetësues të tjerë financiarë, përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve pensionale
123 01	Ndërmjetësues të tjerë financiarë publikë
123 02	Ndërmjetësues të tjerë financiarë privatë
123 03	Ndërmjetësues të tjerë financiarë të kontrolluar nga jashtë
124	Institucione financiare ndihmëse
124 01	Institucione financiare ndihmëse publike
124 02	Institucione financiare ndihmëse private
124 03	Institucione financiare të kontrolluara nga jashtë
125	Shoqëri sigurimi dhe fonde pensionale
125 01	Shoqëri sigurimi publike dhe fonde pensionale
125 02	Shoqëri sigurimi private dhe fonde pensionale
125 03	Shoqëri sigurimi dhe fonde pensionale të kontrolluara nga jashtë
13	Shteti
1311	Qeveria qendrore
1314	Fondet e Sigurimeve Shoqërore
1313	Vetëqeverisja lokale
14	Amvisëri
15	Institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive

2. Sektori i kreditorit

Kodi	Sektori
31	Shoqëri jofinanciare
31 001	Shoqëri publike jofinanciare
31 002	Shoqëri private jofinanciare
31 003	Shoqëri jofinanciare të kontrolluara nga jashtë
32	Shoqëri financiare
321	Banka qendrore
322	Institucione të tjera monetare dhe financiare
322 01	Institucione monetare dhe financiare publike
322 02	Institucione private monetare dhe financiare
323	Ndërmjetësues të tjerë financiarë, përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve pensionale
323 01	Ndërmjetësues të tjerë financiarë publikë
323 02	Ndërmjetësues të tjerë financiarë privatë
324	Institucione financiare ndihmëse
324 01	Institucione financiare ndihmëse publike
324 02	Institucione financiare ndihmëse private
325	Shoqëri sigurimi dhe fonde pensionale
325 01	Shoqëri sigurimi publike dhe fonde pensionale
325 02	Shoqëri sigurimi private dhe fonde pensionale
33	Shteti
3311	Qeveria qendrore
3314	Fondet e Sigurimeve Shoqërore
3313	Vetëqeverisja lokale
34	Amvisëri
35	Institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive
36	Organizata ndërkombëtare financiare

3. Lloji i kredisë

Kodi	Kredia
01	Kredi komerciale
02	Kredi për mallra
03	Kredi financiare (hua)
05	Emetimi i letrave me vlerë të borxhit
06	Kontratë për riblerjen e letrës me vlerë (kontratë-repo)
07	Kredi subordinare
08	Kredi e sindikuar
09	Alokimi i DSP-së
10	Lizingu financiar

4. Qëllimi i llojeve të veçanta të kredive

Kredi komerciale (01)

Kodi	Qëllimi
01	Importi i pajisjeve
05	Importi i lëndëve të para dhe mallrave repromateriale
09	Shërbime të pranuar
10	Importi i mallrave për konsum të gjerë
20	Paradhënie
27	Investime

Kreditë e mallrave(02)

Kodi	Qëllimi
01	Pagesat në bazë të importit të pajisjeve
03	Për projektet e infrastrukturës publike
04	Për konsum publik
05	Pagesa në bazë të importit të lëndëve të para dhe mallrave repromateriale
09	Pagesat në bazë të importit të shërbimeve
10	Pagesat në bazë të importit të mallrave të konsumit të gjerë
27	Investime

Kredi financiare (03)

Kodi	Qëllimi
01	Prokurimi i pajisjeve
02	Për reformat strukturore
03	Për projektet e infrastrukturës publike
04	Për konsum publik
05	Prokurimi i lëndëve të para dhe mallrave repromateriale

06	Për të mbështetur bilancin e pagesave
09	Shërbimet e marra
10	Prokurimi i mallrave të konsumit
22	Për shlyerjen e kredive të përdorura më parë
27	Investimet
44	Kredia konsumatore
67	Blerja e aksioneve në kompanitë vendase
69	Kapital punues (pasuri qarkulluese)
71	Ripozicionimi i mjeteve

Emetimi i letrave me vlerë të borxhit (05)

Kodi	Qëllimi
01	Emetimi i letrave me vlerë të borxhit

Kontrata e riblerjes së letrave me vlerë – kontratë repo(06)

Kodi	Qëllimi
01	Kontratë për riblerjen e letrave me vlerë –kontratë- epo

Kredi subordinare (07)

Kodi	Qëllimi
01	Kredi subordinare

Kredi subordinare (08)

Kodi	Lloji
01	Kredi e sindikuar

Alokime DSP (09)

Kodi	Qëllimi
06	Për mbështetjen e bilancit të pagesave

Lizing financiar (10)

Kodi	Qëllimi
01	Prokurimi i pajisjeve
02	Shfrytëzimi i pronave të paluajjtshme

5. Formë sigurimi

Kodi	Sigurimi
1	Dorëzani
2	Garanci
3	Kambial
4	Kambiali i vet
5	Hipotekë

6	Depozita
7	Të tjera
8	Hipotekë për prona të paluajtshme
9	Pengu i letrave me vlerë

6. Lloje të normave të interesit

Kodi	Norma e interesit
0101	LIBOR1 m.
0102	LIBOR 2 m.
0103	LIBOR 3 m.
0104	LIBOR 4 m
0105	LIBOR 5 m.
0106	LIBOR 6 m
0107	LIBOR 7 m.
0108	LIBOR 8 m.
0109	LIBOR 9 m.
01010	LIBOR 10 m.
01011	LIBOR 11 m.
01012	LIBOR 12 m.
0801	EURIBOR m.
0802	EURIBOR 2 m.
0803	EURIBOR 3 m.
0804	EURIBOR 4 m.
0805	EURIBOR 5 m.
0806	EURIBOR 6 m.
0807	EURIBOR 7 m.
0808	EURIBOR 8 m.
0809	EURIBOR 9 m.
0810	EURIBOR 10 m.
0811	EURIBOR 11 m.
0812	EURIBOR 12 m.
0901	IBRD-çmimi i huamarrjes së kualifikuar3 m.
0902	IBRD - çmimi i huamarrjes së kualifikuar6 m.
0903	IBRD - çmimi i huamarrjes së kualifikuar12 m.
10	FMN-norma bazë
20	Norma fikse
30	Pa interes

Shtojcë-formularë

1. LLOJI I RAPORTIMIT

1 Data e evidentimit

2 Numri i kredisë

3 Numri i dokumentit

4 Emri i projektit

5 Aplikimi i ri

6 Ndryshimi i aplikimit

Data

7 Anulimi i aplikimit

Data

8 Anulimi i pjesës së papërdorur të kredisë

Data

SHUMA

2. MARRËVESHJE PËR KREDI

1 Data e kontratës

2 Lloji i kontratës

<-

7 Afati i kredisë

MUAJ

3 Aplikimi kornizë

4 Kodi i riorganizimit

5 Shuma e kredisë

6 Monedha

Emërimi

<-

8 Periudha e pritjes

MUAJ

3. DEBITORI

1 NVAQ

Titulli/emri

2 Sektori

Emri i sektorit

Adresa / Selia

4. KREDITORI

1 Kodi

Titulli/emri

2 Shteti

<-

3 Sektori

Emri i sektorit

<-

4 Personat e lidhur

Lloji

<-

Pjesëmarrja

%

5. LLOJI DHE QËLLIMI I KREDISË

1 Lloji i kredisë

<-

2 Qëllimi i kredisë

<-

6. SIGURIA

1 I siguruar

po

2 Lloji i sigurisë

<-

3 NVAS/kodi

Emri dhe selia

4 E garantuar publikisht

po

jo

<-

jo

7. KRYEGJËJA

1 Mënyra e pagesës Kryegjësja në shumë të barabarta	2 Buxheti Po	3 Numri i pagesave në vit <-
Pagesa të parregullta të kryegjësës/*	Jo	4 Numri i përgjithshëm i pagesave
Anuiteti Shuma e anuitetit	5 Data e parë e pagesës 	
Në një shumë	6 Data e fundit e pagesës 	
Përdorimi individual Numri i muajve		

/* Dokumenteve u bashëngjitet plani i pagesës

8. INTERESI

1 Lloji i normës së interesit <-	2 interesit % Shuma e normës së	3 Marzha %	4 Data e parë e pagesës 	5 Data e fundit e pagesës
6 Kamatvonesa <-	7 interesit %	8 Marzha %		
9 Numri i pagesave në vit 	10 Mënyra e llogaritjes së interesit			
	Për muaj		Për vit	
	1 Me kalendar	1 Me kalendar		
	2 30 ditë	2 360 ditë		

9. SHPENZIME

1. Vjetor	2. Një herë
Për pjesën e papërdorur të kredisë %	%
Për menaxhimin e kredisë %	%
Për organizimin e kredisë %	%
Shpenzime tjera %	%

10. SHFRYTËZUES I KREDISË

1 NVAQ 	Titulli/emri
	Adresa / Selia

11. INSTITUCIONI I HUAJ SIGURIMI

1 Kodi 	Emërimi 	Selia 	Shteti 	2 Përqindja e sigurimit %
--------------------------------	---------------------------------	-------------------------------	--------------------------------	---

12. RAPORTUESI PËR APLIKIMIN

1 NVAQ 	Titulli/emri
	Adresa / Selia
2 Personi për kontakt:	
Emri	
Telefon	Faks
e-mail	Nënshkrimi

13. SHËNIM

14. VËRTETIMI I APLIKIMIT - DEBITORI

Emri dhe mbiemri i përgjegjës

Nënshkrimi-debitori

ND 2

10. Gjendja e borxhit

[illegible]

Nënshkrimi

ND 3

1 Numri i kredisë	4 Kryegjëja	6 E re	
2 Numri i dokumentit	5 Interesi	7 Anulimi i shlyerjes	Numri i dokumentit
3 Shuma e përgjithshme e pagu			

[illegible]

13. SHËNIM

14. RAPORTUESI

Data e dorëzimit

Nënshkrimi

ND 4

1 Numri i kredisë

2 Numri i dokumentit

3 Shuma totale e planit

4 Plan i ri

5 Anulimi në plan

Numri i dokumentit

[illegible]

9. SHËNIM

10. RAPORTUES

Data e dorëzimit

Nëshkrimi

ND 5

[illegible]

18. RAPORTUES

Nënshkrimi